

Vendim nr. 187 datë 15.09.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Marjana Semini,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 15.09.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (I) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ILIR MUZHAQI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-424, datë 15.06.2021 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, shkronja “F”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ilir Muzhaqi është proceduar penalisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të procedimit penal të regjistruar me nr. 3664, të vitit 2009 (*nr. 3664/2009*), për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Në

përfundim të hetimeve, prokuroria, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronjat “b” dhe “dh”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. 3664/2009.

2. Mbi bazën e ankimit të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Prokuroria e Përgjithshme në datën 20.02.2012 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit, duke e dërguar çështjen penale sërish për vijimin e hetimeve pranë së njëjtës prokurori. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 10.10.2017, ka vendosur rrëzimin e ankimit të kërkuesit, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin 134, datë 29.01.2018. Kundër këtij të fundit ka ushtruar rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-424, datë 15.06.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe i panënshkruar nga mbrojtësi ligjor, në kundërshtim me parashikimet e nenit 435 të KPP-së. Sipas Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka marrë dijeni për vendimin e arsyetuar të gjykatës së apelit, nëpërmjet dëftesës së komunikimit në datën 22.02.2018 dhe atij i ka lindur e drejta e ushtrimit të rekursit nga e nesërmja e kësaj date, pra më 23.02.2018. Ndërkohë, rekursi është postuar më 24.07.2019, duke u administruar në ditën e 517-të të tij. Gjithashtu, kërkuesi është njoftuar me shkresën e datës 21.10.2019, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin e mbrojtësit ligjor, sipas nenit 435, pika 2, të KPP-së, por nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik për të plotësuar të metat e rekursit në përputhje me kërkesat ligjore.

5. Me shkresën nr. 3420/1 prot., datë 22.06.2023, Gjykata e Lartë e ka informuar kërkuesin se vendimi nr. 00-2021-424, datë 15.06.2021 është bërë i disponueshëm për palët në datën 22.07.2021 dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit të saj në datën 23.07.2021.

6. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual të regjistruar në datën 07.07.2023, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-424, datë 15.06.2021 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, pasi Gjykata e Apelit Tiranë nuk ia ka njoftuar vendimin brenda afateve, por është vënë në lëvizje vetëm pas kërkesës së tij, ndërkohë që vendimi është dhënë në mungesë të tij në dhomën e këshillimit dhe pa pasur asnjë shpjegim të

arsyetuar ligjor. Po kështu, aktet procedurale të asaj gjykate janë të pavlefshme për shkak të pjesëmarrjes së një gjyqtari të ndodhur në kushte papajtueshmërie. Dëftesa e komunikimit të vendimit të gjykatës së apelit është e falsifikuar, pasi nënshkrimi nuk është i tij. Gjithashtu, veprimet e gjyqtarëve kanë pasur si qëllim mbrojtjen e prokurorit, kanë abuzuar duke shkelur rëndë ligjin procedural dhe dëmtuar interesat e ligjshëm të tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuësit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

9. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kolegji vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi gjyqësor i kundërshtuar prej tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Një tjetër kriter paraprak që duhet të përmbushet nga individ i përpara se t’i drejtohet kësaj Gjykate lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individ i pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në këtë Gjykatë

(shih vendimet nr. 4, datë 08.02.2023; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 54, datë 24.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar në objektin e ankimit kushtetues individual vendimin nr. 00-2021-424, datë 15.06.2021 të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për rrëzimin e kërkesës së tij, me objekt ankimin e vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. 3664/2009. E thënë ndryshe, kërkuesi ka kundërshtuar vendimin, i cili i ka hapur rrugë hetimit penal ndaj tij.

13. Për sa më sipër, vendimi nr. 00-2021-424, datë 15.06.2021 i Gjykatës së Lartë nuk është përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi jo vetëm që nuk vendos në mënyrë përfundimtare për thelbin e së drejtës së kërkuetit, që ka të bëjë me fajësinë ose pafajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën ai akuzohet, por as nuk është provuar se ka ndonjë efekt të tillë cenues në të drejtat themelore të tij, të cilat nuk mund të mbrohen gjatë gjykimit të zakonshëm.

14. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave gjatë shqyrtimit të themelit të çështjes, ku mund të ngrejë pretendime në lidhje me cilësimin juridik të fakteve ose cenimin e të drejtave kushtetuese nga vendimi objekt i këtij gjykimi, si dhe të paraqesë të gjitha provat që i konsideron të nevojshme në mbështetje të pretendimeve të tij, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet ligjore efektive në dispozicion, për rrjedhojë kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.